



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1170 prot.

Tiranë, më 25. 10. 2023

V E N D I M

Nr. 216, datë 25. 10. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi², është paraqitur ankesa nr. 199 Regj., datë 02.10.2023, e shtetasit A. P., kundër Institutit të Sigurimeve Shoqërore³ dhe Drejtorisë Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Elbasan⁴, me pretendim diskriminimin për shkak të etnisë dhe aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se subjekti ankues, ndër vite ka qenë në marrëdhënie pune në Komisaratin e Policisë Peqin për periudhën 01.09.1994-11.09.1996. Gjithashtu, ankuesi thekson se trajtohet me pension invaliditeti nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Referuar dokumentacionin bashkëlidhur ankesës, ankuesi duke mos rënë dakord me përlllogaritjen e masës së pensionit të invaliditetit me pretendimin se nuk i janë marrë në konsideratë vitet e punës që ka ushtruar detyrën e punonjësit të policisë pranë Komisarimit të Policisë Peqin, përmes shkresës nr. 591, datë 12.03.2019, i është drejtuar me ankim fillimisht Komisionit Rajonal të Ankimit, pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan. Në përgjigje të kërkesës së tij, Komisioni Rajonal i Ankimit, me Vendimin nr. 311, datë 06.12.2019, ka rrëzuar kërkesën e tij si të pabazuar në prova dhe në ligj.

¹ Në vijim referuar me akronimin LMD.

² Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

³ Në vijim referuar me akronimin ISSH.

⁴ Në vijim referuar me akronimin DRSSH Elbasan.

Duke mos rënë dakord me vendimmarrjen e Komisionit Rajonal të Ankimit, ankuesi i është drejtuar me ankim Komisionit Qendror të Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Pas shqyrtimit të ankimit të A. P., Komisioni Qendror i Ankimit me Vendimin nr. 304, datë 10.03.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij.

Në ankesën e depozituar pranë KMD-së, subjekti ankues, ndër të tjera, shprehet si më poshtë citohet:

“Jam pakicë kombëtare greke, jam baba, jam inxhinier, jam ushtarak, përfundimisht tani jam edhe invalid pune. Bashkëngjitur keni dy vendime të ISSH-së dhe DRSSH-së Elbasan. Do ju lutesha, t’i lexoni me kujdes se si një inxhinier, japin këtë lëmoshë të paparë...?!”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan, për shkaqet sipërcituar.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet kur: (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja e dënjësive për sjelljen diskriminuese”. Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërit prej kushteve të mësipërme.

Nga aktet shkresore të depozituara nga ankuesi⁵, rezulton se, pretendimet e subjektit ankues lidhen me vendimmarrjet e Komisionit Rajonal të Ankimit Elbasan dhe Komisionit Qendror të Ankimit Tiranë, sa i përket përlogaritjes së masës së pensionit të invaliditetit.

Në rastin që ankuesi, ka kundërshti dhe mosdakordësi lidhur me vendimin e Komisionit Rajonal të Ankimit Elbasan dhe Komisionit Qendror të Ankimit Tiranë, Komisioneri informon subjektin ankues, se vendimi i këtij Komisioni kundërshtohet gjyqësisht, pasi Gjykata jep vendimin përfundimtar lidhur me këtë çështje.

Në analizë të nenit 86 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhur me të drejtën e ankimit, parashikohet se:

“ 1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; Ankimi në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel;

2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar.....”.

⁵ Vendimit nr. 311, datë 06.12.2019 të Komisionit Rajonal të Ankimit dhe Vendimit nr. 304, datë 10.03.2020 të Komisionit Qendror të Ankimit.

Në Rregulloren e miratuar me vendimin Nr. 22, datë 30.11.2016 të Këshillit Administrativ të ISSH-së *“Për përbërjen, numrin dhe procedurën e funksionimit të Komisioneve të Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”*, përcaktohen rregullat dhe procedurat e dorëzimit të kërkesave ankimore dhe marrja në shqyrtim të tyre; dhënia e zgjidhjeve të bazuara ligjore për ankimet; caktimi i procedurës së marrjes së përgjigjes së ankesës si dhe, në rastet e përgjigjeve të pafavorshme, të krijimi i mundësinë së ankimit të personave në gjykatë.

Ndër të tjera në paragrafin 52 të Rregullores së sipërcituar, përcaktohet se: *“52. Vendimi përfundimtar i Komisionit Qendror të Ankimit është i detyrueshëm për zbatim. Ky vendim kundërshtohet vetëm në gjykatë;”*.

Referuar në sa më sipër, vlerësohet se, DRSSH Elbasan, Komisioni Rajonal i Ankimit të DRSSH Elbasan dhe Komisioni Qendror i Ankimit pranë ISSH-së, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, kanë detyrimin ligjor për të verifikuar dokumentacionin e disponueshëm sipas përcaktimeve të Rregullores Nr. 22, datë 30.11.2016 të Këshillit Administrativ të ISSH-së.

Sikurse vihet re nga parashikimet e paragrafit 6 të Rregullores përcaktohet se: *“Vendimi i Degës së Përfitimeve” është një akt juridiko-administrativ, me anën e të cilit, personit të siguruar, i njihet ose refuzohet e drejta për një lloj përfitimi afatgjatë apo afatshkurtër nga sigurimet shoqërore (skema e detyrueshme), i cili bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;”*. Ndërsa në paragrafin 17, parashikohet se: *“Komisionet e Ankimit shqyrtojnë kërkesat dhe ankesat e personave për pensionet e pleqërisë, invaliditetit, pensionet familjare, si dhe çdo përfitim tjetër të njohur sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;”*. Në këtë kuptim, është Dega e Përfitimeve ajo e cila bën shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit për llogaritjen dhe përfitimin e pensionit nga ana e kërkuësve, ndërsa Komisionet e Ankimit shqyrtojnë kërkesat dhe ankesat e personave për pensionet e pleqërisë, invaliditetit, pensionet familjare, si dhe çdo përfitim tjetër.

Në analizë për sa më sipër, rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtyre organeve (Komisioneve Rajonale të Ankimit, pranë DRSSH-ve apo Komisionit Qendror të Ankimit, pranë ISSH) nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁶.

Neni 42 i Kushtetutës vendos standarde kushtetuese si për gjykatat, ashtu dhe për organet e administratës publike. Pika 2 e po këtij neni, sanksionon se kushdo mund t'i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Kjo dispozitë, ndër të tjera, ka për

⁶ Të njëjtin qëndrim Komisioneri ka mbajtur edhe në vendimet Nr. 113, datë 10.06.2022 dhe Nr. 11, datë 23.01.2023.

qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar dhe rastin kur cenimi vjen dhe nga një akt administrativ i tillë.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar në ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”⁷, të ndryshuar; t’i drejtoheni Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për të kundërshtuar vendimet e Komisioneve Rajonale të Ankimit apo Komisionit Qendror të Ankimit pranë ISSH.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Gjithashtu, rezulton se data e ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është 10.03.2020, pra momenti kur është marrë vendimi i fundit i Komisionit Qendror të Ankimit Tiranë sa i përket përlllogaritjes së pensionit të invaliditetit të ankuesit. Ndërkohë që, nuk parashtrohet asnjë informacion nga ankuesi se kur ka marrë dijeni mbi diskriminimin e pretenduar.

Për sa më sipër, KMD gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është data **10.03.2020**, kur me Vendimin nr. 304, datë 10.03.2020, të Komisionit Qendror të Ankimit Tiranë, ankuesit i është rrëzuar kërkesa për rilloaritjen e pensionit të invaliditetit. Pavarësisht faktit, që nga ana e ankuesit nuk është dhënë asnjë informacion lidhur me marrjen dijeni mbi momentin e diskriminimit të pretenduar, ajo nuk mund të jetë më vonë se muaji pasardhës kur ankuesi ka tërhequr masën e pensionit të pandryshuar, pra rreth muajit **Prill 2020**. Ndërkohë që, data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është **02.10.2023**. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit daton më shumë se 3 (vjet) nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar. Njëkohësisht, edhe momenti, i marrjes dijeni mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 199, datë 02.10.2023 pranë KMD-së.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e shtetasit A. P., nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

⁷ Neni 86, pika 3 e tij.

Pra, në përfundim konkludojmë se ankesa nuk mund të pranohet dhe nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj, pasi janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, si dhe është e papajtueshme me dispozitat e tij.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/dh, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues A. P., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Etnia dhe aftësia e kufizuar)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)